



e Rahovecit

Gazetari gjerman, Erich Rathfelder, dekorohet me medaljen “Qytetar nderi” i Rahovecit

Me propozimin e kryetarit të Komunës, Smajl Latifi, Kuvendi i Komunës merr vendim për dhënien e dekoratës “Qytetar nderi” i Rahovecit, gazetarit gjerman, Erich Rathfelder, i cili ka bërë punë të pakursyer në hulumtimin dhe paraqitjen e të vërtetës gjatë luftës nga agresori serb në Kosovë duke lobuar nëpër shtetet e tjera të Evropës.



Komuna e Rahovecit nënshkruan marrëveshje me pagesë, me praktikantë



Komuna e Rahovecit ka nënshkruar marrëveshje me praktikantë, me pagesë për 6 muaj, në bashkëpunim me sektorin privat. Pas thirrjes së lansuar nga Komuna e Rahovecit për praktikantë, me pagesë, në bashkëpunim me sektorin privat, u finalizuan marrëveshjet mes kompanive private dhe kandidatëve të përzgjedhur, ku 50% të pagesës mujore e mbulon Komuna, ndërsa 50% biznesi privat.

Komuna e Rahovecit nënshkruan memorandum mirëkuptimi me strehimoren “Shtëpia e sigurt”



Komuna e Rahovecit, së bashku me drejtoren e strehimores “Shtëpia e sigurt”, znj. Erblina Dinarama, nënshkruan memorandum mirëkuptimi për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të strehimores "Shtëpia e sigurt" në periudhën prej 3 vitesh 2023-2025.

Ky memorandum do të sigurojë mbështetje financiare të pjesshme për nevojat e strehimores për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës mbi bazën gjinore, si dhe viktimat e përkohshme të qenieve njerëzore.

Funksionalizohet kanalizimi i ujërave të zeza në segmentin e parë të rr. “Vëllezërit Frashëri” në qytet



Për dhjetë ditë pune, me shumë vështirësi, është kryer dhe funksionalizuar kanalizimi i ujërave të zeza në segmentin e parë të rr. “Vëllezërit Frashëri” në qytet, një shqetësim i madh dhe nevojë jetike për qytetarët e kësaj lagjeje.

Diku rreth 50 shtëpi banimi, tashmë kanë qasje në kanalizimin e ujërave të zeza dhe nuk do të përballen më me këtë problem.